



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5486 prot.

Himarë, më 17.07.2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për Planin Vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Himarë ”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ✓

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin “ Për Planin Vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Himarë ”.

Bashkëngjitur projektvendimi dhe relacioni sqarues për këtë projektvendim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5486/2 prot.

Himarë, më 17.07.2025

RELACION SQARUES

Lënda: “Për miratimin e Planit vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Himarë”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Nisur nga rëndësia që ka edukimi i hershëm në zhvillimin social, emocional dhe intelektual të fëmijëve, si dhe nga domosdoshmëria për të përmirësuar cilësinë dhe aksesin në institucionet e arsimit parashkollor në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë, është hartuar Plani vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor, si një dokument strategjik për periudhën 2025–2028. Ky plan synon të garantojë të drejtën për arsim të barabartë për të gjithë fëmijët, pa dallim vendbanimi, statusi social apo ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Plani Vendor për Arsimin Parashkollor përbën një instrument të rëndësishëm të qeverisjes vendore, i cili udhëzon dhe përqendron politikat e bashkisë në drejtim të:

- zgjerimit të përfshirjes së fëmijëve në çerdhe dhe kopshte publike;
- përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimit të ambienteve të reja;
- rritjes së cilësisë së edukimit përmes kualifikimit të stafit edukues;
- krijimit të një mjedisi të sigurt, të shëndetshëm dhe stimulues për fëmijët;
- përfshirjes së komunitetit dhe prindërve në procesin edukues.

Plani përmban masa konkrete për:

- rehabilitimin dhe pajisjen e institucioneve ekzistuese;
- rritjen e mbulimit të territorit me shërbime parashkollore, veçanërisht në zonat rurale;
- rritjen e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve profesionale për edukatorët dhe ndihmës personelin;
- zhvillimin e programeve të edukimit gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj diversitetit.

Përmes këtij plani, bashkia himarë angazhohet të ndërmarrë veprime konkrete që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe rritjen e mundësive të tyre për zhvillim të shëndetshëm dhe të barabartë që në hapat e parë të jetës. Për sa ju parashtruam në këtë relacion, dhe në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit nr. 69/2012 “për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e shqipërisë”, kërkojmë miratimin e planit vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor 2025–2028 nga ana e këshillit bashkiak të bashkisë himarë.

DREJTORI

Aida Halilaj



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 5486/prot.

Himarë, më 17.07.2025

PROJEKTVENDIM

NR. 36 DATË 17.07.2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT
PARASHKOLLOR 2025–2028 TË BASHKISË HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”; nenit 24; nenit 54, shkronja “k”; dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; si dhe në përputhje me Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e arsimit parashkollor, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratohet “Plani vendor për zhvillimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Himarë, i cili përfshin objektivat, prioritetet dhe masat konkrete për periudhën 2025–2028, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në arsim parashkollor për të gjithë fëmijët në territorin e bashkisë.
2. Plani synon rritjen e përfshirjes së fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor, përmirësimin e infrastrukturës fizike, zhvillimin profesional të stafit edukues dhe sigurimin e standardeve cilësore të edukimit të hershëm.

3. Ngarkohen Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë, Drejtoria e finances dhe planifikimit të buxhetit dhe strukturat përkatëse për ndjekjen e zbatimit të planit, në bashkëpunim me institucionet arsimore.

4. Efektet financiare për zbatimin e planit do të përballohen nga buxheti vjetor i Bashkisë Himarë dhe burime të tjera të mundshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORI

Aida Halilaj



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 548 6/3 prot.
17.07.2025

PLANI VENDOR PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË BASHKINË HIMARË 2026-2028

Tabela e përmbajtjes	
1. Hyrje	4
2. Të dhëna të përgjithshme	5
Konteksti administrativ	5
Të dhëna demografike.....	5
Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve	6
Frekuentimi	8
Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar	8
Frekuentimi në arsimin fillor	10
Frekuentimi arsimit 9-vjecar	10
Frekuentimi arsimit i mesëm.....	Error! Bookmark not defined.
Profili i njësive administrative	10
Njësia Administrative: Himarë	Error! Bookmark not defined.
Njësia Administrative: Horë-Vranisht.....	Error! Bookmark not defined.
Njësia Administrative: Lukovë	14
3. Plani 2026 -2028	16
Hyrje	16
Buxheti i Planifikuar për Arsimin (2025–2028)	18
Arsimi Parashkollor	Error! Bookmark not defined.
Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	Error! Bookmark not defined.
Prioritetet dhe objektivat.....	18
Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshëm i infrastruktures arsimore	19
Të sigurohet mirëritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.....	19
Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.....	20
4. Plani i investimeve.....	21
Ndërtimi i shkollave të reja për përmirësimin e infrastruktures arsimore.	21
5. Monitorimi i planit.....	24
Monitorimi sipas objektivave	25
Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshëm i infrastruktures arsimore	25

Monitorimi i aktiviteteve i aktiviteteve.....	26
Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.....	35
Monitorimi i aktiviteteve i aktiviteteve.....	36
Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.....	39
Monitorimi i aktiviteteve	40
ANEKSI 1: Protokolli i funksionimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Himarë.....	49

1. Hyrje

Ky raport përfaqëson një analizë të detajuar të situatës së shërbimit të arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë për periudhën 2024–2025.

Analiza është hartuar me qëllim të mbështetjes së proceseve të planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes në fushën e arsimit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi burimet ekzistuese, sfidat aktuale dhe mundësitë për përmirësim.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të shërbejë si bazë për hartimin e politikave arsimore afatmesme për periudhën 2026–2028, duke u fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në përputhje me nevojat lokale të popullsisë, tendencat demografike, shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore dhe burimet njerëzore dhe infrastrukturore në dispozicion.

Raporti synon gjithashtu të identifikojë boshllëqet në aksesin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve arsimore me qëllim që të krijohen kushte të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashki.

2. Të dhëna të përgjithshme

Konteksti administrativ

Bashkia Himarë është e përbërë nga tre njësi administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 3 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukture dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Himarë përfshin gjithsej 3 njësi administrative:


- Himarë
- Horë-Vranisht
- Lukovë

të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Himarë është 8,328 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 4,262 meshkuj dhe 4,066 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.

Numri i banoreve sipas gjinise




■ Femer ■ Mashkull

Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve

Në Bashkinë Himarë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Himarë funksionojnë 12 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Në territorin e Bashkisë Himarë janë të shpërndara gjithsej 11 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.

Frekuentimi

Në Bashkinë Himarë, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 128, prej të cilëve 79 janë në zonat urbane dhe 49 janë zonat rurale.

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 55.32% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 50.55% e djemve dhe 59.79% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.

Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3-6 vjeç në territorin e Bashkisë Himarë.

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar


Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (1 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (5 gjithsej) dhe shkolla të mesme (1 gjithsej) si dhe shkolla të mesme të bashkuara (3 gjithsej).

Shkollat fillore u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.

Shkollat 9-vjeçare, gjithsej 5 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

Shkollat e mesme, në numër prej 4, që përfshijnë gjimnazet dhe shkollat e mesme të bashkuara, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Frekuentimi në arsimin fillor

Në arsimin 9 vjeçar janë të regjistruar gjithsej 185, nga të cilët 146 vajza janë dhe 39 djem. Ndërsa në arsimin e mesëm janë të regjistruar 80 dhe në arsimin e mesëm të bashkuar janë 242. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimësisë së përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Frekuentimi arsimit 9-vjeçar :

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 185 nxënës, prej të cilëve 68 janë djem dhe 117 vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Frekuentimi i arsimit të mesëm :

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 322 nxënës, nga të cilët 80 janë djem dhe 242 vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkollë të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.


PROFILI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE

Njësia administrative Himarë :

Në total, funksionojnë 3 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 3 shkolla janë të arsimit 9-vjeçar, ndërsa 1 prej tyre është shkollë e mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë. Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

Ndarja e shkollave sipas kategorizimit



■ 9vjecare ■ mesme

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
PANO MENIKO
Gjik Bixhili
Niko Aleksi
SPIRO GJIKNURI
Omiros private

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte dhe 1 çerdhe, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve. Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Himare
Niko Aleksi
Gjik Bixhili
Omiros private

NJËSIA ADMINISTRATIVE: HORË-VRANISHT

Shkollat

Në total, funksionojnë 2 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Këto 2 shkolla janë të mesme të bashkuara që nënkupton në mesin e tyre kanë në funksionalitet sistemin e mësimdhënies nga parashkollor deri tek të mesme të përgjithshme, të cilët ofrojnë ciklin bazë të arsimit dhe u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë për të hyrë në tregun e punës pas përfundimit.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
Shkolla e mesme e bashkuar "HYSEN ÇINO"
Shkolla e mesme e bashkuar "MEMO METO"

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë

për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:


Emri i kopshtit
Memo Meto ku përfshihen fëmijët e fshatit Kuç dhe Kuç-Buronja
Hysen Çino ku përfshihen fëmijët e fshatit Bolen, Vranisht, Tërbaç dhe Kallarat

Njësia Administrative: Lukovë

Shkollat

Në total, funksionojnë 4 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkollë e ciklit fillor, ndërsa 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkolla e mesme e bashkuar që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale. Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkolles
LUKOVA
QAZIM PALI
VASIL LLAÇI
KOZMA PAPADHIMA

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njesisë janë të

hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Lukova, Lukovë
Kozma Papadhima, Nivicë
Qazim Pali Borsh si dhe kopshtii i lagjes Fermës në total 2 kopshte
Vasil Llaçi, Piqeras

3. Plani 2026 -2028

Hyrje

Plani i Arsimit 2026–2028 përfaqëson një strategji afatmesme që synon përmirësimin e cilësisë, aksesit dhe barazisë në sistemin arsimor. Ai është hartuar në përputhje me prioritetet kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe me nevojat e identifikuara në nivel vendor, me qëllim ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, të orientuar drejt nxënësit dhe të përshtatur me kërkesat e kohës.

Ky plan fokusohet në disa shtylla kryesore:

- **Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësit**, përmes trajnimeve të vazhdueshme për mësuesit, përditësimit të kurrikulave dhe nxitjes së metodave bashkëkohore pedagogjike.
- **Zgjerimi i aksesit në arsim**, veçanërisht për fëmijët nga grupet e marginalizuara dhe në zonat rurale.
- **Modernizimi i infrastrukturës shkollore**, duke përfshirë pajisjen me mjete teknologjike, përmirësimin e kushteve fizike dhe dixhitalizimin e proceseve arsimore.
- **Forcimi i menaxhimit dhe qeverisjes në arsim**, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.
- **Nxitja e përfshirjes së komunitetit dhe partnerëve lokalë**, si një faktor kyç për garantimin e vijimësisë në arsim dhe suksesit të politikave të zbatuara.

Plani parashikon objektiva të matshme për çdo vit, burime të përcaktuara dhe një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të progresit, duke siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar

drejt rezultateve konkrete në përmirësimin e sistemit arsimor.

Qëllimet strategjike :

Të zhvillohet dhe modernizohet infrastruktura arsimore

-Sigurimi i një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe funksional për çdo institucion arsimor
-Investime sistematike në infrastrukturë, kushte higjeno-sanitare, ngrohje, rrethim objektivash dhe materiale didaktike, etj.

Objektivat për këtë qëllim :

- ☐ **O1.1:** Garantimi i funksionimit të përditshëm të institucioneve arsimore përmes angazhimit të stafit edukator dhe atij ndihmës, sigurimit të kushteve bazë si mirëmbajtja, ngrohja, uji, ushqimi, higjiena, transporti dhe kancelaria.
- ☐ **O1.2:** Investime për rikonstrukcione, zgjerim kapacitetesh dhe sisteme informacioni për menaxhim dhe transparencë.

Të rritet mirëqenia dhe cilësia e zhvillimit të fëmijëve

-Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale dhe edukimit të personalizuar
-Përfshirja e fëmijëve në nevojë dhe angazhimi i familjes në procesin arsimor

Objektivat për këtë qëllim :

O2.1: Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore.

O2.2: Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale.

O2.3: Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

Të promovohet pjesëmarrja aktive dhe formimi qytetar i fëmijëve

-Zhvillimi i aktiviteteve jashtëmësimore për sport, kulturë, krijimtari dhe mjedis

-Ndërtimi i ndjenjës së përkatësisë dhe bashkëpunimit në komunitetin shkollor

Objektivat për këtë qëllim :

O2.1: Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore.

O2.2: Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale.

O2.3: Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

Shtyllat udhëheqëse të vizionit të bazuara në përfshirje dhe barazi:

Asnjë fëmijë jashtë sistemit arsimor, me fokus të veçantë tek fëmijët e moshës 3–6 vjeç dhe grupet në nevojë. Politika për barazi gjinore, përfshirje të komuniteteve romë dhe egjiptiane, dhe mbështetje për fëmijët me aftësi ndryshe.

***Cilësi dhe zhvillim profesional:**

Rritja e standardeve të mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të stafit edukativ dhe ndihmës.

Përmirësimi i metodologjive të të nxënit përmes qasjes aktive, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt të ardhmes.

***Infrastrukturë dhe mjedis edukues:**

Rikonstruktimi dhe zgjerimi i kopshteve dhe shkollave për të garantuar mjedise të sigurta, të pastra dhe funksionale.

Pajisje bashkëkohore didaktike dhe digjitale në çdo institucion.

***Zhvillim i hershëm dhe kujdes parashkollor:**

Investim në arsimin e hershëm për fëmijët 0–6 vjeç si themel i suksesit në edukimin e mëtejshëm.

Rritje e kapacitetit të kopshteve publike dhe partneritete me sektorin privat.

***Bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin:**

Fuqizimi i rolit të prindërve në procesin edukativ përmes forumeve, trajnimeve dhe këshillave të kopshtit/shkollës.

Nxitja e ndjenjës së përkatësisë dhe kujdesit të përbashkët për institucionet arsimore.

Buxheti i Planifikuar për Arsimin (2026–2028)

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar ngarkesën buxhetore të bashkisë, mënyrën e përdorimit të fondeve publike për arsimin, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Shërbimi i arsimit parashkollor financohet nëpërmjet dy burimeve kryesore të të ardhurave: të ardhurat vendore nga taksat dhe tarifat, si dhe transferimet nga qeveria qendrore.

- **Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore** për arsimin parauniversitar përbëjnë një komponent të rëndësishëm të buxhetit, duke reflektuar angazhimin e bashkisë për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare për shërbimet vendore që ka kompetencë.
- **Transferimet e pakushtëzuaara sektoriale nga qeveria qendrore** mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin e institucioneve arsimore, duke përfshirë pagat e stafit dhe shpenzimet operative.

Prioritetet dhe objektivat

Nr	Objektivi
1	Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore
2	Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.
3	Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.

Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore

Pershkrimi:

Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore

Lista e aktiviteve:

Nr	Periudha	Titulli i veprimtarise	Vitet
1	Brenda vitit	Mirembajtja dhe permiresimi i vazhdueshem i infrastruktures arsimore	2026,2027,2028
2	Brenda vitit	Garantimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve higjeno-sanitare	2026,2027,2028
3	Brenda vitit	Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2026,2027,2028
4	Brenda vitit	Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2026,2027,2028
5	Brenda vitit	Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit	2026,2027,2028
6	Brenda vitit	Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2026,2027,2028
7	Brenda vitit	Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2026,2027,2028
8	Brenda vitit	Furnizimi dhe shërbimi ushqimor për mensat në institucionet e arsimit parashkollor	2026,2027,2028
9	Brenda vitit	Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve të domosdoshme mbështetëse për funksionimin e institucioneve arsimore	2026,2027,2028
10	Brenda vitit	Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2026,2027,2028

Të sigurohet mirërritja dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative cilësore dhe forcimit të përkujdesjes sociale.

Pershkrimi:

Të garantohet mirërritja, edukimi dhe zhvillimi i gjithanshëm i fëmijëve në kopshte, shkolla, konvikte dhe qendra kulturore, përmes ofrimit të një shërbimi cilësor edukues për fëmijët, si dhe përmes forcimit të shërbimeve të integritit dhe të përkujdesjes sociale.

Lista e aktiviteteve:

Nr	Periudha	Titulli i veprimtarise	Vitet
1	Brenda vitit	Mbështetja me shërbim transporti të nxënësve nga familjet në nevojë	2026,2027,2028
2	Brenda vitit	Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera nëpërmjet bursave të ekselencës	2026,2027,2028
3	Brenda vitit	Mbështetja e punonjësve të institucioneve arsimore për zhvillimin profesional dhe zhvillimin e kurrikulës	2026,2027,2028
4	Brenda vitit	Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	2026,2027,2028
5	Brenda vitit	Trajnimi i stafit pedagogjik të edukatorëve për identifikimin dhe referimin e hershëm të fëmijëve me vështirësi në zhvillim.	2026,2027,2028

Promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve përmes veprimtarive jashtëmësimore që nxisin shëndetin, krijimtarinë dhe vlerat qytetare.

Pershkrimi:

Ky objektivi synon të ofrojë mundësi të larmishme jashtë kurrikulës mësimore për fëmijët, duke nxitur zhvillimin personal, sjelljet e shëndetshme, krijimtarinë, përfshirjen sociale dhe formimin e tyre në frymën e vlerave qytetare dhe universale.

Lista e aktiviteteve:

Nr	Periudha	Titulli i veprimtarise	Vitet
1	23-30 shtator	Java Evropiane e Sportit	2026,2027,2028
2	Prill-Maj	Java Olimpikë	2026,2027,2028
3	20 nëntor	Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve	2026,2027,2028
4	21 nëntor	Dita e Luftës Kundër Bullizmit	2026,2027,2028
5	Brenda vitit	Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe	2026,2027,2028
6	3 dhjetor	Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	2026,2027,2028
7	22 Mars	Dita Botërore e Ujit (UNESCO)	2026,2027,2028
8	23 prill	Dita Botërore e Librit	2026,2027,2028
9	5 qershor	Dita Botërore e Mjedisit	2026,2027,2028

4. Plani i investimeve

Ndërtimi i shkollave të reja për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Përmirësimi i infrastrukturës arsimore përmes restaurimit të shkollave të reja, me qëllim garantimin e kushteve bashkëkohore për një proces mësimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Periudha	Titulli i veprimtarisë	Vitet	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Buxheti 2028
		2026,2027,2028			
		2026,2027,2028			

Aktivitetet: O1.1: Garantimi i funksionimit të përditshëm të institucioneve arsimore përmes angazhimit të stafit edukator dhe atij ndihmës, sigurimit të kushteve bazë si mirëmbajtja, ngrohja, uji, ushqimi, higjiena, transporti dhe kancelaria.

- Pagat dhe sigurimet: Mbështetje financiare për personelin arsimor dhe mbështetës (paga + sigurime).
- Mirëmbajtje infrastrukture: Ndërhyrje për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së ambienteve.
- Higjiena: Pastrim ditor dhe përmirësim i standardeve sanitare në shkolla dhe kopshte.
- Ngrohja: Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes për kushte komode.
- Materiale kancelarie: Furnizim i rregullt me mjete administrative dhe mësimore.
- Fikset e zjarrit: Pajisje, kontroll dhe kolaudim për siguri nga zjarri.
- Dokumentacion administrativ: Furnizim me regjistra dhe formularë për funksionimin e brendshëm.
- Mjete didaktike: Pajisje bashkëkohore për mbështetje të mësimdhënies dhe zhvillimit të nxënësve.
- Ushqimi në kopshte: Sigurimi i vakteve të shëndetshme për fëmijët në institucionet parashkollore.
- Dezinfektimi: Zbatim i rregullt i shërbimeve për sigurinë shëndetësore.
- Transporti institucional: Mjete për nevoja logjistike të institucioneve arsimore

Aktivitetet: O1.2: Investime për rikonstruksione, zgjerim kapacitetesh dhe sisteme informacioni për menaxhim dhe transparencë

- Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë
- Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor
- Investime për pajisje në godinat e arsimit bazë dhe parashkollor
- Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit të mesëm të përgjithshëm
- Investime për pajisje në godinat e arsimit të mesëm të përgjithshëm
- Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat: Dixhitalizim

Aktivitetet: O2.1: Të forcohet cilësia e edukimit në kopshtet ekzistuese përmes trajnimeve të rregullta për edukatorët dhe përdorimit të mjeteve didaktike bashkëkohore.

- Pajisje me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët
- Fuqizimi i kapaciteteve (trajnim)të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Aktivitetet: O2.2: Të zgjerohet oferta e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe specialistëve të mbështetjes psiko-sociale.

- Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte
- Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.
- Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte
- Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë
- Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera

Aktivitetet: O2.3: Të krijohen dhe fuqizohen mekanizma të bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet për të rritur ndërgjegjësimin prindëror dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes në procesin edukativ.

- Fushata për prindërit: Informim dhe edukim i prindërve në zonat me akses të kufizuar mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.
- Identifikim dhe mbështetje: Bashkëpunim me punonjës socialë për të evidentuar dhe ndihmuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për arsye sociale ose ekonomike.
- Fuqizim strukturash këshilluese: Aktivizimi i bordeve të shkollave, këshillave të prindërve dhe komisioneve të sigurisë në shkolla dhe kopshte.
- Përfshirje e komunitetit: Angazhimi i prindërve dhe organizatave lokale në vendimmarrje dhe monitorim të arsimit për të rritur transparencën dhe bashkëpronësinë.

Aktivitetet: O3.1: Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale për zhvillimin emocional dhe bashkëpunimin mes fëmijëve.

- Java Evropiane e Sportit (23–30 Shtator)
Loja popullore, ushtrime në natyrë, gara me biçikleta dhe aktivitete lëvizore.
- Java Olimpikë (Prill–Maj)
Stafeta, gara vrapimi dhe aktivitete sportive mes kopshteve.
- Dita e të Drejtave të Fëmijëve (20 Nëntor)
Biseda dhe ekspozitë: “Të drejtat e mia”, aktivitete në natyrë.
- Dita Kundër Bullizmit (21 Nëntor)
Biseda dhe aktivitete ndërgjegjëse për fëmijët.
- Dita e Alfabetit Shqiptar
Postera dhe koncert për gjuhën shtëpiake.

- Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara (3 Dhjetor)
Loja me role, biseda dhe ekspozitë nga fëmijët me aftësi ndryshe.
- Dita Botërore e Gjuhës Amtare
Vizita në bibliotekë dhe aktivitete për gjuhën shqipe.
- Dita Botërore e Ujit (22 Mars)
Biseda, postera dhe eksperimente mbi rëndësinë e ujit.
- Dita Ndërkombëtare e Romëve
Biseda mbi zakonet, traditat dhe përfshirjen e fëmijëve romë.
- Dita Botërore e Librit (23 Prill)
Vizita në bibliotekë, aktivitete krijuese dhe fushatë “Dhuro një libër”.
- Dita Botërore e Mjedisit (5 Qershor)
Aktivitet riciklimi, mbjellje lulesh, ekspozita dhe ekskursione.
- Yjet e Vallëzimit
Konkurs vallëzimi midis kopshteve të qytetit
- Vizita në bibliotekë – për Ditën e Gjuhës Amtare dhe Ditën Botërore të Librit.
- Ekskursione edukative – në muze, galeri arti, qendra sportive dhe aktivitete komunitare.
- Fushata “Dhuro një libër, hap një dritare” – mbështetur nga institucionet kulturore.
- “Pedalo për turizëm dhe kulturë” – pedalim publik + ekspozitë me vizatime dhe punime të fëmijëve.
Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Periudha: 3 dhjetor Ky aktivitet ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë respektin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes dhe barazisë në të gjitha fushat e jetës. Në institucionet arsimore organizohen aktivitete sensibilizuese, trajnime dhe punëtori që përfshijnë nxënës, mësues dhe komunitetin lokal, me fokus në mbështetjen dhe integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Bashkia ka një rol mbështetës, duke koordinuar bashkëpunimin ndërmjet shkollave, qendrave sociale dhe organizatave të specializuara, si dhe duke ofruar mbështetje materiale dhe infrastrukturore për realizimin e aktiviteteve. Përmes kësaj dite, bashkia synon të nxisë një ambient gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë fëmijët dhe qytetarët e saj.

Monitorimi i ndikimit në komunitet

Shkollat

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i shkollave	Numri i fëmijëve	Numri i shkollave	Numri i fëmijëve	Përqindja e shkollave	Përqindja e fëmijëve
11	507			100	100

Kopshtet

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Përqindja e shkollave	Përqindja e fëmijëve
12	128			100	100

Monitorimi i realizimit

0 – Aktiviteti nuk ka nisur.

1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Monitorimi i aktivitetit:

Dita Botërore e Ujit (UNESCO)

Periudha: 22 Mars Ky aktivitet ndërgjegjësuës shënon rëndësinë jetike të ujit për jetën dhe mjedisin, duke promovuar përdorimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e burimeve ujore. Në institucionet arsimore zhvillohen aktivitete edukative, si ligjërata, punëtori dhe ekspozita, për të sensibilizuar nxënësit mbi sfidat e menaxhimit të ujit dhe rëndësinë e kursimit të tij.

Bashkia ka një rol mbështetës duke bashkëpunuar me shkollat, organizatat mjedisore dhe komunitetin lokal për organizimin dhe promovimin e aktivitetit. Përmes kësaj dite, bashkia

kontribuon në edukimin e brezit të ri për një përdorim më të përgjegjshëm të ujit dhe mbrojtjen e mjedisit natyror.

Monitorimi i ndikimit në komunitet

Shkollat

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i shkollave	Numri i femijeve	Numri i shkollave	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
11	507			100	100

Kopshtet

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
12	128			100	100

Monitorimi i realizimit

0 – Aktiviteti nuk ka nisur.

1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Monitorimi i aktivitetit:

Dita Botërore e Librit

Periudha: 23 prill Çdo vit, më 23 prill, bota feston Ditën Botërore të Librit, një ditë dedikuar magjisë së leximit, fuqisë së fjalës së shkruar dhe trashëgimisë kulturore që librat na dhurojnë. Kjo ditë, e cila u vendos nga UNESCO në vitin 1995, synon të nxisë tek të gjithë – fëmijë, të rinj dhe të rritur – dashurinë për librin dhe leximin si një rrugë drejt dijes, kreativitetit dhe dialogut kulturor.

Në nivel lokal, bashkia bashkëpunon ngushtë me institucionet arsimore për të organizuar një sërë aktiviteteve që përfshijnë lexime të përbashkëta, ekspozita librash, konkurse shkrimi dhe takime me autorë. Këto aktivitete synojnë jo vetëm të frymëzojnë nxënësit të zbulojnë botën përmes librave, por edhe të forcojnë lidhjen mes komunitetit dhe traditës së pasur kulturore shqiptare.

Roli i bashkisë është të krijojë një mjedis mbështetës dhe të ofrojë burimet e nevojshme për realizimin e këtyre eventeve, duke promovuar vlerat e leximit nëpërmjet fushatave sensibilizuese dhe duke bashkëpunuar me bibliotekat dhe organizatat kulturore. Në këtë mënyrë, Dita Botërore e Librit bëhet një moment i rëndësishëm për të nxitur edukimin, për të kultivuar imagjinatën dhe për të ndërtuar një shoqëri më të informuar dhe më të lidhur me kulturën.

Monitorimi i ndikimit ne komunitet

Shkollat

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i shkollave	Numri i femijeve	Numri i shkollave	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
11	507			100	100

Kopshtet

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
12	128			100	100

Monitorimi i realizimit

0 – Aktiviteti nuk ka nisur.

1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Monitorimi i aktivitetit:

Dita Botërore e Mjedisit

Periudha: 5 qershor Çdo vit, më 5 qershor, festohet Dita Botërore e Mjedisit, një ditë kushtuar ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Kjo ditë na kujton përgjegjësinë e përbashkët për të ruajtur planetin tonë dhe për të vepruar në mënyrë të ndërgjegjshme për të ardhmen e brezave të ardhshëm.

Në nivel lokal, bashkia luan një rol mbështetës në organizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe edukative, duke bashkëpunuar ngushtë me shkollat dhe komunitetin për të promovuar praktika miqësore ndaj mjedisit. Në institucionet arsimore zhvillohen punëtori, ekspozita dhe fushata pastrimi, ku nxënësit angazhohen aktivisht për të mësuar dhe për të vepruar në mbrojtje të mjedisit.

Përmes këtij aktiviteti, bashkia synon të ndërgjegjësojë qytetarët dhe të nxisë një kulturë përgjegjësie dhe kujdesi ndaj natyrës, duke ndihmuar në zhvillimin e një komuniteti më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm.

Monitorimi i ndikimit ne komunitet

Shkollat

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i shkollave	Numri i femijeve	Numri i shkollave	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
11	507			100	100

Kopshtet

Planifikimi		Realizimi		Përqindje	
Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Numri i kopshteve	Numri i femijeve	Përqindja e shkollave	Përqindja e femijeve
12	128			100	100

Monitorimi i realizimit

0 – Aktiviteti nuk ka nisur.

1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Drejtorja e çështjeve sociale, arsimit dhe të rinisë

Aida Halilaj

Drejtorja juridike

Ardit Muhametaj

Drejtorja e financës dhe planifikimit të buxhetit

Laert Mezani



PROTOKOLL

I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT PARASHKOLLOR NË BASHKINË HIMARË



BASHKIA HIMARË

PROTOKOLL

**I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT PARASHKOLLOR NË BASHKINË
HIMARË**

Nr. 5486 / 4 prot.,

datë 17.07.2025

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË HIMARË

Vangjel Tavo





TABELA E PËRMBAJTJES

- HYRJE
- QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE BAZA LIGJORE E NEVOJSHME
- PËRKUFIZIME MBI PROTOKOLLIN
- OBJEKTIVAT E PROTOKOLLIT
- PERSONELI DHE PËRGJEGJËSITË
- PROCESI EDUKATIVO-MËSIMOR
- DOKUMENTACIONI DHE RAPORTIMI
- KUJDESI DHE SIGURIA
- MONITORIMI DHE VLERËSIMI
- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
- **ANEKS 3** HARTA E SHËRBIMEVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR NE TERRITORIN E BASHKISE HIMARË DHE KONTAKTET E STAFIT EDUKATIV
- **ANEKS 4** FORMULAR REGJISTRIMI NË KOPËSHT
- **ANEKS 5** PROCESVERBAL TAKIMIT ME PRINDER
- **ANEKS 6** FORMULAR VLERËSIMI MBI ECURINË INDIVIDUALE TË FËMIJES NË KOPËSHT
- **ANEKS 7** PROCEDURA E MBLEDHJES SË BORDIT
- **ANEKS 8** FORMULAR I RAPORTIMIT TË FEMIJES NË NEVOJË PËR MBROJTJE
- **ANEKS 9** PYETËSOR PER PRINDËRIT – BASHKIA HIMARË



1. HYRJE

Arsimi parashkollor përfaqëson fazën themelore dhe të pazëvendësueshme në zhvillimin e fëmijëve, duke shërbyer si bazë për formimin e aftësive të para sociale, emocionale, gjuhësore dhe njohëse. Kjo periudhë është vendimtare për përgatitjen e fëmijëve për arsimin fillor dhe për përfshirjen e tyre të suksesshme në jetën shoqërore.

Në këtë kuadër, **Protokolli i Funksionimit në Sistemin Parashkollor** synon të rregullojë mënyrën e organizimit, ofrimit dhe bashkërendimit të shërbimeve edukativo-arsimore për fëmijët nga 0 deri në 6 vjeç, në përputhje me standardet ligjore, pedagogjike dhe administrative në fuqi.

Ky protokoll shërben si dokument orientues për institucionet parashkollore publike dhe private, për autoritetet vendore dhe për të gjithë aktorët e përfshirë në kujdesin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve, me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës, zhvillues dhe cilësor.

Ky protokoll përfaqëson angazhimin konkret të palëve për të bashkëvepruar në funksion të të drejtës për arsim të çdo fëmije dhe për të siguruar një sistem arsimor më të drejtë, më gjithëpërfshirës dhe më efektiv për brezat që vijnë.

1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE BAZA LIGJORE E NEVOJSHME

Qëllimi i këtij protokoll është të vendosë një kuadër bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përkatëse vendore dhe arsimore, me synimin për të garantuar funksionimin efikas, gjithëpërfshirës dhe cilësor të sistemit të arsimit parashkollor në territorin e Bashkisë Himarë.

Ky bashkëpunim synon të:

- ☐ Të sigurojë shërbime cilësore të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve nga 0 deri në 6 vjeç, në përputhje me standardet kombëtare;
- ☐ Të rregullojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, strukturave vendore dhe prindërve në ofrimin e shërbimeve parashkollore;
- ☐ Të garantojë mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe nxitës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve;
- ☐ Të përforcojë mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në institucionet e arsimit parashkollor.



Përmes këtij protokolli, palët nënshkruese angazhohen të ndërmarrin veprime të koordinuara për të përmbushur detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre ligjore në funksion të zhvillimit të një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Baza Ligjore

Protokolli i funksionimit në sistemin parashkollor bazohet në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht në:

1. **Ligji nr. 69/2012**, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – ku arsimit parashkollor përcaktohet si faza e parë e sistemit arsimor dhe shërben për zhvillimin e hershëm të fëmijëve;
2. **Ligji nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” – i cili garanton të drejtën e çdo fëmije për arsim cilësor dhe zhvillim gjithëpërfshirës në një mjedis të sigurt;
3. **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 742**, datë 11.11.2020, “Për miratimin e standardeve të zhvillimit të hershëm të fëmijërisë” – që përcakton normat për cilësinë e shërbimeve në çerdhe dhe kopshte;
4. **Udhëzimi nr. 26**, datë 04.10.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për funksionimin e arsimit parashkollor” – që përmban rregulla praktike për organizimin pedagogjik dhe administrativ të institucioneve parashkollore;
5. **Ligji nr. 139/2015**, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar – i cili përcakton rolin e njësisë të qeverisjes vendore në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve publike, përfshirë ato të arsimit parashkollor;
6. **Aktet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe të pushtetit vendor**, që rregullojnë aspekte të tjera organizative, financiare dhe procedurale.

2. PËRKUFIZIME MBI PROTOKOLLIN

Sistemi parashkollor përfshin të gjitha institucionet arsimore dhe edukative që ofrojnë kujdes dhe edukim për fëmijët nga mosha **0 deri në 6 vjeç**, përpara hyrjes në arsimin bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky sistem përbëhet nga:

- **Çerdhet:** institucione që ofrojnë shërbime për kujdesin, edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve nga **0 deri në 3 vjeç**,
- **Kopshtet:** institucione që ofrojnë edukim të strukturuar për fëmijët nga **3 deri në 6 vjeç**.

Sistemi parashkollor synon:



- Zhvillimin e aftësive bazë të fëmijëve,
- Nxitjen e të nxënit përmes lojës dhe ndërveprimit social,
- Përgatitjen e tyre për hyrjen në arsimin fillor.

Sistemi zbatohet nga institucionet publike dhe private, në bashkëpunim me strukturat vendore dhe qendrore, duke respektuar standardet kombëtare të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme.

3. OBJEKTIVAT E PROTOKOLLIT

- **Sigurimi i kushteve për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve** në fazën parashkollore, duke krijuar një ambient të sigurt, stimulues dhe të përshtatshëm për zhvillimin fizik, emocional, social dhe intelektual të tyre.
- **Rregullimi i orarit, procesit edukativo-arsimor dhe shërbimeve mbështetëse**, në mënyrë që të përmbushen nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe familjeve, duke siguruar një organizim efikas dhe cilësor të ditës parashkollore.
- **Promovimi i bashkëpunimit aktiv dhe efektiv me familjen dhe komunitetin lokal**, për të forcuar mbështetjen sociale dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore dhe edukative në fazën parashkollore.

4. PERSONELI DHE PËRGJEGJËSITË

☐ **Personeli arsimor dhe edukativ** (mësues, edukatorë, kujdestarë) duhet të jetë i kualifikuar dhe i trajnuar për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve në fazën parashkollore. Ata janë përgjegjës për zbatimin e programeve edukative, organizimin e aktiviteteve dhe ndjekjen e zhvillimit të çdo fëmije.

☐ **Drejtuesit e institucioneve parashkollore** kanë përgjegjësinë për menaxhimin e efikasitetit të punës së stafit, zbatimin e protokolleve dhe standardeve të arsimit parashkollor, si dhe për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për fëmijët dhe personelin.

☐ **Personeli mbështetës** (psikologë, punonjës socialë, sanitare, kujdestarë) ka përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve që ndihmojnë në mirëqenien dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve, duke bashkëpunuar ngushtë me personelin edukativ dhe prindërit.

☐ **Bashkëpunimi me prindërit dhe familjet** është një detyrë e përbashkët e të gjithë stafit, përmes informimit të rregullt, organizimit të takimeve dhe aktiviteteve bashkëpunuese që përforcojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.



- ☐ **Përgjegjësia për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve** gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion i takon të gjithë stafit, i cili duhet të veprojë sipas protokolleve të sigurisë, duke parandaluar rreziqet dhe duke vepruar shpejt në raste emergjence.
- ☐ **Trajnimi dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm** i personelit është i detyrueshëm dhe mbështetet nga institucioni për t'u siguruar që stafi të jetë në përputhje me standardet më të mira të arsimit dhe kujdesit parashkollor.

5. PROCESI EDUKATIVO-MËSIMOR

- ☐ Zbatohen programet dhe kurrikulat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të përshtatura për moshën dhe nevojat e fëmijëve në fazën parashkollore.
- ☐ Organizohen aktivitete të ndryshme edukative, kreative dhe sociale që stimulojnë zhvillimin fizik, emocional, intelektual dhe social të fëmijëve.
- ☐ Promovohet përdorimi i metodave aktive të mësimdhënies, duke përfshirë lojën si mjet kryesor i të nxënit dhe zhvillimit.
- ☐ Sigurohet vlerësimi i vazhdueshëm i zhvillimit të fëmijëve dhe evidentimi i nevojave individuale për mbështetje shtesë.
- ☐ Bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindërit për informimin mbi përparimin dhe nevojat e fëmijëve, përmes takimeve dhe raporteve periodike si dhe kërkesave të parashtruara nga bordi i prindërve.

6. DOKUMENTACIONI DHE RAPORTIMI

- **Mbajtja e dokumentacionit të plotë dhe të përditësuar** për çdo fëmijë, duke përfshirë regjistrin e pranisë, evidencën e aktiviteteve, zhvillimin individual, gjendjen shëndetësore dhe pjesëmarrjen në aktivitete edukative.
- **Mbajtja e dokumentacionit të plotë për regjistrimin e çdo fëmije çdo vit të ri akademik** duke përfshirë të gjitha ato dokumentacione të kërkuara në formularin e regjistrimit.
- **Dokumentet administrative dhe pedagogjike** duhet të ruhen në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Raportimi i rregullt** nga stafi pedagogjik dhe drejtuesit e institucionit bëhet pranë autoriteteve përgjegjëse të arsimit dhe strukturave komunale, në formën e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore.
- **Raportet përfshijnë informacion mbi:**
 - Praninë dhe mungesat e fëmijëve,



- Ecurinë edukativo-arsimore dhe sociale të fëmijëve,
- Ndryshimet dhe ngjarjet e rëndësishme në institucion,
- Nevojat për mbështetje shtesë dhe rekomandimet për ndërhyrje,
- Çështjet shëndetësore dhe masat parandaluese.
- **Komunikimi i rregullt me prindërit/familjet**, përmes takimeve, bisedave individuale dhe raporteve shkollore, për të siguruar transparencë dhe përfshirje aktive në procesin edukativ.
- **Ruajtja dhe arkivimi** i dokumentacionit duhet të jetë në përputhje me detyrimet që pushteti vendor kërkon në çdo monitorim të kopshtit apo çerdhes.

7. KUJDESI DHE SIGURIA

- ☐ **Institucionet vendore janë të detyruara të garantojnë një ambient të sigurt, të pastër dhe të përshtatshëm për sistemin parashkollor** ku përfshinë moshën e fëmijëve nga 0-6 vjeç, në përputhje me standardet e miratuara nga autoritetet përkatëse.
- ☐ **Siguria fizike dhe psikologjike e fëmijëve** është prioritet parësor. Çdo masë parandaluese duhet të merret për të shmangur rreziqet e brendshme dhe të jashtme gjatë qëndrimit të fëmijëve në institucion.
- ☐ **Stafi edukativ dhe ndihmës** është i trajnuar për të reaguar në mënyrë të menjëhershme dhe profesionale në raste emergjente, incidente shëndetësore ose situata të papritura.
- ☐ **Kontrolli i ambienteve, lodrave, pajisjeve dhe hapësirave të jashtme** bëhet nga personeli përgjegjës për të identifikuar çdo faktor rreziku dhe për të garantuar mjedis të sigurt.
- ☐ **Higjiena personale dhe kolektive** promovohet përmes rregullave të përditshme për larjen e duarve, përdorimin e banjove, pastrimin e duhur të ambienteve dhe edukimin e fëmijëve për shëndetin dhe pastërtinë.
- ☐ **Prania dhe dalja e fëmijëve** kontrollohet rreptësisht dhe të komunikojë me prindërit/kujdestarët. Fëmijët dorëzohen vetëm te personat e autorizuar.
- ☐ **Komunikimi me shërbimet shëndetësore dhe emergjencat** (ambulanca, policia, zjarrfikësja) është i strukturuar dhe sigurohet ndërhyrje e shpejtë kur nevojitet.
- ☐ **Raste të dyshuara të abuzimit, neglizhencës apo keqtrajtimit** raportohen menjëherë pranë institucioneve përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me ligjin.

8. MONITORIM DHE VLERËSIMI



- **Monitorimi i zbatimit të protokollit** realizohet në mënyrë të rregullt nga autoritetet kompetente të arsimit dhe bashkisë, për të siguruar respektimin e standardeve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë protokoll.
- **Auditime dhe inspektime periodike** kryhen në institucionet parashkollore për të vlerësuar cilësinë e mjedisit, procesit edukativ dhe shërbimeve mbështetëse.
- **Vlerësimi i performancës së stafit pedagogjik dhe mbështetës** bëhet në bazë të indikatorëve të përcaktuar, duke marrë parasysh angazhimin, zhvillimin profesional, marrëdhëniet me fëmijët dhe prindërit, si dhe zbatimin korrekt të programeve edukative.
- **Vlerësimet e cilësisë së shërbimeve** përfshijnë shqyrtimin e kushteve infrastrukturore, higjieno-sanitare, sigurinë dhe nivelin e mbështetjes sociale dhe shëndetësore për fëmijët.
- **Raportet e monitorimit dhe vlerësimit** bëhen nga institucioni vendor sipas vlersimit të punës për çdo educator të realizuar në mënyrë kofidenciale nga prindrit e fëmijës dhe specialistit për arsimin dhe rinin pranë bashkisë. Ku në një relacion parashtron rekomandimet për përmirësime dhe masa korrigjuese kur është e nevojshme.
- **Përfshirja e prindërve dhe komunitetit** në proceset e monitorimit dhe vlerësimit inkurajohet për të siguruar transparencë dhe bashkëpunim.

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- ☐ Ky protokoll hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë.
- ☐ Çdo ndryshim, plotësim apo rishikim i këtij protokollit mund të bëhet vetëm me propozim të Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet raportimeve periodike që do ti vijnë nga specialist i arsimit.
- ☐ Angazhohen për zbatimin e plotë dhe të pandërprerë të këtij protokollit i gjithë stafi edukativ që vepron në territorin e Bashkisë Himarë, duke siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin e nevojshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve parashkollore.

Kontaktet e Eduatoreve në territorin e Bashkisë Himarë:

- **Kopshti Qender grupi 1** : Edukatore - Nexhmie Denaj, Tel: +355 0695126060;
- **Kopshti Qender grupi 2** : Edukatore - Zhaneta Çela, Tel: +355 0694783613
- **Çerdhe Qender grupi 1** : Edukatore - Etleva Kongjini, Tel: +355 0696442997
- **Kopshti Dhermi grupi 1** : Edukatore - Suzana Beleri, Tel: +355 0695660273
- **Kopshti Qeparo grupi 1** : Edukatore - Kristina Guma, Tel: +355 0698397088
- **Kopshti Qazim Pali : grupi 1** : Edukatore - Rigerta Lala, Tel: +355 0693380002
- **Kopshti Qazim Pali : grupi 2** : Edukatore - Saimira Vela, Tel: +355 06908551672
- **Kopshti Piqeras grupi 1** : Edukatore - Matilda Rami, Tel: +355 0677151742



- **Kopshti Lukova grupi 1:** Edukatore - Parashqevi Kocaqi, Tel: +355 0698422510
- **Kopshti Nivicë grupi 1:** Edukatore - Lorenca Duka, Tel: +355 0684878148
- **Kopshti Horë-Vranisht grupi 1:** Edukatore - Antoneta Aliraj, Tel: +355 0697684191
- **Kopshti Horë-Vranisht grupi 2:** Edukatore - Elisabeta Lamaj, Tel: +355 0685742562
- **Kopshti Kuç grupi 1:** Edukatore - Mbarime Merkaj, Tel: +355 0697915225

ANEKS 3: HARTA E SHËRBIMEVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR NË TRRITORIN E BASHKISË HIMARË

Njësia administrative Himarë :

- Kopshti Qendër në varësi të shkollës 9-vjeçare “Pano Nikolla Meniko”, Godinë më vete me dy grupe fëmijësh përfshirë dhe çerdhen.
- Kopshti në fshatin Dhërmi në varësi të shkollës 9-vjeçare “Gjik Bixhili”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.
- Kopshti në fshatin Qeparo në varësi të shkollës 9-vjeçare “Niko Aleksi”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.

Njësia administrative Lukovë

- Kopshti në fshatin Borsh në varësi të shkollës së mesme të bashkuar “Qazim Pali”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.
- Kopshti në fshatin Borsh, lagja “Fermë” në varësi të shkollës së mesme të bashkuar “Qazim Pali”, Godinë jasht shkollës me një grup fëmijësh.
- Kopshti në fshatin Piqeras në varësi të shkollës fillore “Vasil Llaçi”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.
- Kopshti në fshatin Lukovë në varësi të shkollës 9-vjeçare “Lukova”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.
- Kopshti në fshatin Nivicë në varësi të shkollës 9-vjeçare “Kozma Papadhima”, Godinë jasht shkollës me një grup fëmijësh.

Njësia Amdinistrative Horë Vranisht:

- Kopshti në njësinë Horë-Vranisht në varësi të shkollës së mesme të bashkuar “Hysen Çino”, Godinë brenda shkollës me dy grup fëmijësh.



-Kopshti në fshatin Kuç në varësi të shkollës së mesme të bashkuar “Memo Meto”, Godinë brenda shkollës me një grup fëmijësh.

ANEKS 4: FORMULAR REGJISTRIMI NË KOPSHT

Viti Akademik 2025–2026

Institucioni Parashkollor (Emri i Kopshtit): _____
Njësia Administrative: _____

I. TË DHËNA TË FËMIJËS

- Emri dhe mbiemri: _____
- Gjinia: ☐ Mashkull ☐ Femër
- Data e lindjes: ____ / ____ / ____
- Vendlindja: _____
- Adresa e banimit: _____
- Grupi ku do të regjistrohet: ☐ 3–4 vjeç ☐ 4–5 vjeç ☐ Parashkollor (5–6 vjeç)

II. TË DHËNA TË PRINDËRVE / KUJDESTARIT LIGJOR

Nëna:

- Emër, mbiemër: _____
- Nr. ID / Letërnjoftimi: _____
- Numri i telefonit: _____
- Profesioni: _____

Babai:

- Emër, mbiemër: _____
- Nr. ID / Letërnjoftimi: _____
- Numri i telefonit: _____
- Profesioni: _____

Kujdestari ligjor (nëse është i ndryshëm nga prindërit):



- Emër, mbiemër: _____
- Lidhja me fëmijën: _____
- Dokumentacion mbështetës: ☐ Po ☐ Jo

III. TË DHËNA SHITESË PËR FËMIJËN

- Ka ndjekur më parë institucion parashkollor? ☐ Po ☐ Jo
Nëse po, emri i institucionit: _____
- Ka ndonjë sëmundje kronike apo nevojë të veçantë? ☐ Po ☐ Jo
Nëse po, specifikoni: _____
- Është fëmijë me aftësi të kufizuara? ☐ Po ☐ Jo
- Ka nevojë për mësues ndihmës? ☐ Po ☐ Jo ☐ Për t'u vlerësuar
- Vaksinat e detyrueshme të kryera? ☐ Po ☐ Jo (pranoni kopje të kartelës së vaksinimit)

IV. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM (bashkëngjitur)

- ☐ Fotokopje e certifikatës së lindjes
- ☐ Fotokopje e letërnjoftimit të prindërve / kujdestarit
- ☐ Librezë vaksinimi
- ☐ Vërtetim nga mjeku i familjes për gjendjen shëndetësore
- ☐ Dokument për aftësi të kufizuara (nëse ka)

V. DEKLARATË E PRINDËRIT / KUJDESTARIT

Unë, nënshkruari/a _____, deklaroj se të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe marr përsipër t'i njoftoj autoritetet për çdo ndryshim. Jam i vetëdijshëm për rregulloren e institucionit dhe angazhohem të bashkëpunoj për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës tim.

Data: ____ / ____ / 2025 Nënshkrimi: _____

ANEKSI 5 : PROCESVERBAL I TAKIMIT ME PRINDIN

Institucioni Parashkollor: _____

Data: ____ / ____ / ____



Vendi i takimit: _____

Ora: _____

1. PALËT PJESEMARRËSE

Prindi / Kujdestari ligjor:

Emri dhe mbiemri: _____

Lidhja me fëmijën: ☐ Nënë ☐ Kujdestar tjetër

Numri i kontaktit: _____

Përfaqësues të institucionit:

☐ Drejtuesi i institucionit: _____

☐ Edukatori/ja: _____

☐ Psikologu / punonjësi social (nëse është i pranishëm): _____

2. TË DHËNA TË FËMIJËS

- Emri dhe mbiemri: _____
- Data e lindjes: ____ / ____ / ____
- Grupi që ndjek: _____

3. QËLLIMI I TAKIMIT

(Shënohet arsyeja e takimit) _____

- ☐ Vështirësi në zhvillimin gjuhësor
- ☐ Sjellje të përsëritura problematike (agresivitet, izolim, etj.)
- ☐ Dyshime për nevoja të veçanta në të nxënë
- ☐ Neglizhencë ose mungesë e vazhdueshme
- ☐ Vlerësim për ndjekje nga mësues ndihmës
- ☐ Tjetër: _____

4. DISKUTIMI I ZHVILLUAR

(Përshkruhet shkurtimisht biseda, vëzhgimet dhe informacioni i ndarë me prindin)



5. VENDIMET / REKOMANDIMET

- ☐ Vëzhgim i mëtjeshëm nga edukatorja dhe dokumentim i sjelljes
- ☐ Vlerësim psiko-social nga njësia vendore
- ☐ Referim te mjeku i familjes / qendra shëndetësore
- ☐ Këshillim me psikologun e institucionit / bashkëpunim me prindin
- ☐ Aplikim për mbështetje me mësues ndihmës
- ☐ Tjetër: _____

6. DEKLARATË NGA PRINDI / KUJDESTARI

Unë, nënshkruari/a _____, deklaroj se jam informuar për shqetësimet e ngritura dhe do të bashkëpunoj me institucionin në funksion të mbështetjes së fëmijës.

✍ Nënshkrimi i prindit / kujdestarit: _____

✍ Nënshkrimi i edukatorit/es: _____

✍ Nënshkrimi i drejtuesit të institucionit: _____

✍ Nënshkrimi i psikologut/punonjësit social: _____

ANEKSI 6 : FORMULAR VLERËSIMI PËR ECURINË INDIVIDUALE TË FËMIJËS NË KOPSHT

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- Emri dhe mbiemri i fëmijës: _____
- Data e lindjes: ____ / ____ / ____
- Grupi (mosha): _____
- Emri i edukatores: _____
- Emri i institucionit parashkollor: _____
- Data e vlerësimit: ____ / ____ / ____

II. FUSHA TË ZHVILLIMIT DHE OBSERVIMI (Shënohet: Po / Jo / Pjesërisht + Koment nëse ka)

1. Zhvillimi Kognitiv



- Kupton udhëzimet e thjeshta: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Tregon interes për aktivitete mësimore: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Arrin të përqendrohet në detyra për periudha të shkurtra: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Dallon forma, ngjyra, objekte: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht

2. Zhvillimi Gjuhësor dhe Komunikimi

- Flet fjalë të kuptueshme për moshën: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Kupton pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Ndjek dialogje të thjeshta me fëmijët apo të rriturit: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht

3. Zhvillimi Motorik

- Koordinon lëvizjet e duarve dhe këmbëve: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Mbërthen objekte me saktësi: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Kryen veprime të vetë-shërbimit (veshje, ngrënie): ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht

4. Zhvillimi Social dhe Emocional

- Ndërvepron me bashkëmoshatarët: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Shfaq ndjenja në mënyrë të përshtatshme: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht
- Reagon ndaj kritikave dhe kufizimeve: ☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht

III. VËREJTJE DHE SUGJERIME NGA EDUKATORJA / PSIKOLOGU

IV. REKOMANDIME

- ☐ Këshillim me prindërit
- ☐ Vlerësim i mëtejshëm nga specialistë (psikolog, logoped, etj.)
- ☐ Ndjekje nga mësues ndihmës
- ☐ Mbështetje në plan individual mësimor

V. NËNSHKRIMET



- Edukatorja: _____ Data: ____ / ____ / ____
- Psikologu / punonjësi social (nëse përfshihet): _____
- Prindi / Kujdestari ligjor: _____

ANEKSI 7: PROCEDURA E MBLEDHJES SË BORDIT

INSTITUCIONI PARASHKOLLOR (Kopshti) “_____” MBLEDHJA E BORDIT TË PRINDËRVE

Data: ____ / ____ / ____

Ora: _____

Vendi: Ambientet e kopshtit

Lloji i mbledhjes: (Zakonshme / Jashtëzakonshme / Vjetore / Informuese)

Të pranishëm:

1. Drejtoresha e institucionit: _____
2. Mësuese përgjegjëse: _____
3. Përfaqësues të prindërve:
 - Emri dhe mbiemri _____ (klasa/grupi ____)
 - Emri dhe mbiemri _____ (klasa/grupi ____)
 - ...

Të ftuar (nëse ka): _____

Rendi i ditës:

1. Hapja e mbledhjes dhe prezantimi i pjesëmarrësve
2. Informim mbi ecurinë e përgjithshme të fëmijëve
3. Diskutim mbi problematikat e identifikuara gjatë periudhës mësimore
4. Planifikimi i aktiviteteve edukuese dhe sociale për muajt në vijim
5. Çështje të tjera me interes të përbashkët (ushqimi, higjiena, siguria, komunikimi me prindërit)
6. Vendime dhe rekomandime nga bordi
7. Mbyllja e mbledhjes



Përmbledhje e diskutimeve dhe vendimeve:

- **Çështja 1:**
Përmbledhje:
Vendim/Rekomandim:
- **Çështja 2:**
Përmbledhje:
Vendim/Rekomandim:

(Shto sa nevojitet)

Vendimet e marra nga bordi:

1.
2.
3.

Procesverbali u hartua nga:

Emri, Mbiemri:

Detyra: (p.sh. Përgjegjësi i institucionit / Sekretari i bordit)

Nënshkruajnë pjesëmarrësit:

1.
2.
3.

(Lista e nënshkrimeve mund të bashkëngjitet si aneks)



ANEKSI 8 : FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

Data e Lindjes:	Gjinia:
Vendndodhja e Fëmijës / Adresa ku po qëndron në	
Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar:	
Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës: <i>Përmbledh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burimin e rrezikut.</i>	
Arsyet për Raportim / Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:	
Puna e Bërë / Shërbimet e Ofruara.	
Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin:	Data kur është bërë Raportimi:
Emri dhe detajet e kontaktit të personit/institucionit, të cilit i dërgohet formulari:	Formulari është dërguar: Email: nga adresa



ANEKSI 9 : PYETËSOR PËR PRINDËRIT – BASHKIA HIMARË

Kopshti _____

Qëllimi i këtij pyetësori është vlerësimi i cilësisë së shërbimeve në institucionet e edukimit të hershëm dhe identifikimi i fushave që kanë nevojë për përmirësim.

1. Cila është arsyeja kryesore pse zgjidhët këtë kopsht apo çerdhe për fëmijën tuaj?

(Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

- a) Afërsia me vendbanimin
- b) Kostoja ekonomike
- c) Siguria që ofron institucioni
- d) Reputacioni / Rekomandimet
- e) Cilësia e shërbimeve
- f) Arsye të tjera (ju lutemi specifikoni): _____

2. Si e vlerësoni përgatitjen profesionale të stafit edukues?

- a) Shumë të kënaqur
- b) Të kënaqur
- c) As të kënaqur, as të pakënaqur
- d) Të pakënaqur
- e) Nuk kam informacion të mjaftueshëm

3. Nëse keni pasur ndonjë shqetësim apo ankesë, kujt i jeni drejtuar?

(Mund të zgjidhni më shumë se një)

- a) Edukatores
- b) Drejtorisë së institucionit
- c) Bashkisë Himarë
- d) Nuk kam pasur shqetësime deri tani

4. A keni hasur raste të bullizmit ndaj fëmijës tuaj në institucion?



- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

5. Nëse po, nga kush ka ndodhur bullizimi?

- a) Nga fëmijët e tjerë
- b) Nga stafi edukues
- c) Të dyja
- d) Nuk mund të përcaktoj

6. Sa shpesh është ngacmuar fëmija juaj në institucion?

- a) Asnjëherë
- b) 1 herë
- c) Më shumë se 1 herë
- d) Nuk e di / Nuk dua të përgjigjem

7. Si i vlerësoni hapësirat rekreative dhe lodrat në dispozicion në institucion?

- a) Shumë të përshtatshme
- b) Të mjaftueshme
- c) Të pamjaftueshme
- d) Nuk kam informacion

8. Mendoni se duhet të ofrohet drekë në institucion (kopsht/çerdhe)?

- a) Po
- b) Jo
- c) Vetëm me pagesë shtesë

9. A keni ndonjë sugjerim për përmirësimin e shërbimeve në çerdhe apo kopshtin që ndjek fëmija juaj?

**Ky pyetësor është anonim dhe përdoret vetëm për qëllime përmirësimi institucional.
Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!*